



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Në bazë të ligjit nr 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", subjekti që do të nënshkruaj marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit duhet që të paraqesin:

- 1- Kërkesë të argumentuar nga subjekti;
- 2- Ekstraktin historik nga QKR për regjistrimin si person juridik/fizik, ku të rezultojë me status aktiv dhe fusha e veprimtarisë të jetë "Ofrimi testeve ndërkombëtare të gjuhëve të huaja në Republikën e Shqipërisë". Për subjektet juridike "Shoqatat" duhet të paraqitet vendimi i gjykatës;
- 3- Certifikatën e regjistrimit në organet tatimore;
- 4- Vërtetimin nga gjykata dhe vërtetimin nga prokuroria që subjekti nuk është në ndjekje penale apo procedurë falimentimi;
- 5- Vërtetimin nga Drejtoria e Tatimeve dhe organet tatimore vendore për shlyerjen e detyrimeve fiskale përkatëse;
- 6- Vërtetimin nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për shlyerjen e detyrimeve në lidhje me kontributet shoqërore dhe shëndetsore;
- 7- Dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë për testet në gjuhët e huaja sipas aneksit bashkëlidhur udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë";
- 8- Standartet e brendshme të subjektit për administrimin e testeve;
- 9- Deklaratë noteriale nga administratori i subjektit për mos ofrimin e kurseve përgatitore për gjuhët e huaja dhe për mos prodhimin apo shpërndarjen e teksteve për gjuhët e huaja. Administratori i subjektit duhet të deklarojë gjithashtu, që ka të autorizuar subjekte të tjera për kryerjen e veprimtarive të mësipërme.
- 10- Planvendosje të hartuar nga Inxhinier i licencuar për ambiente në pronësi apo të marra me qera nga subjekti, ku do të ofrohet testimi.

Shënim:

Dokumentacioni i mësipërm paraqitet në gjuhë shqipe ose përkthim i noterizuar, në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit nëpërmjet shërbimit postar.

Subjekti njoftohet për nënshkrimin e marrëveshjes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet kontakteve të vendosura në kërkesë.